




| | |
|--|--|
| REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. Dep. <u>2-0/DPK</u> | Nr Prot Bi Prot <u>01-516/14</u> Prot No |
| Nr. l faq Broj stranica <u>02</u> | Data Datum <u>07-02-2014</u> Dzie |
| PRISHTINE | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

| | |
|------------------------|--|
| DATË/A: | 07/02/2014 |
| REFERENC-Ë: | AKK-DPKPP |
| PËR/ZA/TO: | z. Ibrahim HOXHA Menaxher i Prokurimit - Komuna e Podujevë |
| CC: | z. Agim VELIU Kryetar – Komuna e Podujevë |
| NGA/OD/FROM: | z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin “Furnizim me derivate të naftës për Institucionet komunale” |



I nderuar z. HOXHA,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin “Furnizim me derivate të naftës për Institucionet komunale” me nr. të prokurimit: 615-14-001-111, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Furnizim me derivate të naftës për Institucionet komunale” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Komuna e Podujevës, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Furnizim me derivate të naftës për Institucionet komunale” me nr. të prokurimit: 615-14-001-111. Ky aktivitet prokurimi më datë 22/01/2014 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit të kësaj procedure të prokurimit nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 8.1, nënpika a) kërkohet: Qarkullimi financiar në tre vitet e fundit (2011,2012 dhe 2013) vlera prej 500.000,00 €. Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit është dashur të sqaroj nëse qarkullimi i kërkuar financiar është shuma minimale, shumë e cila nuk duhet të kaloj dy herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 9.1, nënpika a) kërkohet: Referencat për furnizime me naftë në tre vitet e fundit (2011, 2012, 2013) minimum në vlerë prej 400.000,00 €. Përveç qarkullimit minimal, Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj edhe referenca në fushën specifike, por shuma e tyre nuk mund të kaloj më shume se 1.5 herë vlerën e parashikuar.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 9.1, nënpika d) kërkohet: OE-fitues i kontratës, duhet të posedoj ose të marr me qira pikën e furnizimit me karburante jo më larg se 4 km nga qendra e qytetit. Autoriteti kontraktues duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial. Autoriteti Kontraktues mundet që të ketë marrëveshje me Operator tjerë Ekonomik, jo domosdoshmërisht duhet të jet operatori në atë afërsi, dhe jo domosdoshmërisht duhet të merr me qera pika karburanti.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; si dhe Neni 5, Gjendja ekonomike dhe Financiare e udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së

Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesit potencial. Pra, të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

